

KIRFN Interpretimi 14**SNK 19—Kufiri mbi Aktivin për Përfitime të Përcaktuara, Kërkesat Minimale të Financimit dhe Bashkëveprimi i tyre****Referencat**

- SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*
- SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*
- SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve* (ndryshuar në 2011)
- SNK 37 *Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara*

Historiku

- Paragrafi 64 i SNK 19 kufizon matjen e një aktivi me përfitim të përcaktuar neto në nivelin më të ulët të tepriçës në skemën e përfitimeve të përcaktuara dhe në çmimin tavan të aktivitetit. Paragrafi 8 i SNK 19 përcakton çmimin tavan të aktivitetit si ‘vlera aktuale e çdo përfitimi ekonomik të aksesueshëm në formën e rimbursimit nga skema ose zvogëlimet në kontributet në të ardhmen të skemës’. Pyetje kanë lindur në lidhje me faktin se kur rimbursimet ose reduktimet në të ardhmen të kontributeve duhet të konsiderohen si të aksesueshme, veçanërisht kur ekziston një kërkesë minimale financimi.
- Kërkesa minimale financimi ekzistojnë në shumë vende për të përmirësuar sigurinë e premtimit për përfitim pas punësimit të bërë anëtarëve të një skeme të përfitimit të punonjësve. Këto kërkesa normalisht nxisin një shumë ose nivel minimal të kontributeve që duhet të derdhet në një skemë gjatë një periudhe të caktuar. Për këtë arsye, një kërkesë minimale për financim mund të kufizojë aftësinë e njësisë ekonomike për të zvogëluar kontributet në të ardhmen.
- Për më tepër, kufizimi në matjen e aktivitetit me përfitim të përcaktuar mund të shkaktojë që një kërkesë minimale financimi të jetë në kushte të rënduara. Normalisht, një kërkesë për të kryer derdhje kontributesh në një skemë nuk do të ndikonte në matjen e aktivitetit ose detyrimit me përfitim të përcaktuar. Kjo për shkak se kontributet, sapo të paguhen, do të kthehen në aktive të skemës dhe për këtë arsye detyrimet shtesë neto do të zerohen. Megjithatë, një kërkesë minimale financimi mund të gjenerojë një detyrim nëse kontributet e kërkuara nuk do të jenë të aksesueshme për njësinë ekonomike me pagimin e tyre.
- Në nëntor 2009 Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ndryshoi KIRFN 14 për të hequr një pasojë të pa synuar e cila vinte si rrjedhojë e trajtimit të parapagimeve të kontributeve të ardhshme në disa situata kur ka një kërkesë minimale financimi.

Objekti

- Ky Interpretim aplikohet në të gjitha përfitimet e përcaktuara pas punësimit dhe në përfitime të tjera afatgjata të përcaktuara të punonjësve.
- Duke pasur për qëllim këtë Interpretim, kërkesat minimale për financim janë çdo kërkesë për të financuar një skemë përfitimesh pas punësimit ose skemë afatgjatë të përfitimeve të përcaktuara.

Çështjet

- Çështjet e prekura nga ky Interpretim janë:
 - kur rimbursimet ose reduktimet në kontributet e ardhshme duhet të konsiderohen si të aksesueshme në përputhje me përkufizimin e çmimit tavan të aktiveve në paragrafin 8 të SNK 19.
 - mënyra se si një kërkesë minimale financimi mund të ndikojë në sigurimin e reduktimeve në kontributet e ardhshme.
 - kur një kërkesë minimale financimi mund t'i japë shtysë një detyrimi.

Konsensusi

Disponueshmëria e një rimbursimi ose reduktimi në kontributet e ardhshme

- 7 Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë disponueshmërinë /aksesueshmërinë e një rimbursimi ose një reduktimi në kontribute të ardhshme në përputhje me afatet dhe kushtet e skemës dhe çdo kërkesë tjetër të detyrueshme nën juridiksionin e skemës.
- 8 Një përfitim ekonomik, në formën e një rimbursimi ose një reduktimi në kontributet e ardhshme, është e vlefshme nëse njësia ekonomike mund ta realizojë atë në një pikë në kohë gjatë jetëgjatësisë së skemës ose kur shlyhen detyrimet e skemës. Në veçanti, ky përfitim ekonomik mund jetë i vlefshëm nëse nuk është i realizueshëm menjëherë në fund të periudhës së raportimit financiar.
- 9 Përfitimi ekonomik i disponueshëm nuk varet në faktin se si njësia ekonomike synon ta përdorë tepricën. Një njësi ekonomike përcakton përfitimin maksimal ekonomik i cili është i disponueshëm nga rimbursimet, reduktimet në kontributet e ardhshme ose një kombinim i të dyjave. Një njësi ekonomike nuk duhet të njohë përfitimet ekonomike nga një kombinim i rimbursimeve dhe reduktimeve në kontribute të ardhshme bazuar në supozime që janë ekskluzive së bashku.
- 10 Në përputhje me SNK 8, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues mbi burimet kyçe të vlerësimit të pasigurisë në fund të periudhës së raportimit, të cilat kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit neto të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar. Kjo mund të përfshijë dhënien e informacioneve shpjeguese mbi çdo kufizim në realizimin aktual të tepricës ose dhënies së informacioneve shpjeguese për bazën e përdorur për të përcaktuar shumën e përfitimit ekonomik të disponueshëm. Njësia ekonomike që zbaton SNRF 19 në vend të tij do të japë këtë informacion shpjegues në përputhje me SNRF 19.

Përfitimet ekonomike të gatshme si një rimbursim

E drejta e një rimbursimi

- 11 Një rimbursim është i gatshëm për një njësi ekonomike vetëm nëse njësia ekonomike ka të drejta të pakushtëzuara për një rimbursim:
 - (a) gjatë jetëgjatësisë së skemës, pa supozuar se detyrimet e skemës duhet detyrimisht të shlyhen në mënyrë që të sigurohet rimbursimi (p.sh. në disa juridiksione, njësia ekonomike mund të gëzojë të drejtën e një rimbursimi gjatë jetëgjatësisë së skemës, pavarësisht nëse detyrimet e skemës shlyhen); ose
 - (b) duke supozuar shlyerjen graduale të detyrimeve të skemës gjatë kohës deri kur të gjithë pjesëmarrësit të kenë lënë skemën; ose
 - (c) duke supozuar shlyerjen e plotë të detyrimeve të skemës në një ngjarje të vetme (d.m.th. si një skemë likuidimi).

Një e drejtë e pakushtëzuar ndaj një rimbursimi mund të ekzistojë në çfarëdolloj niveli financimi të një skeme në fund të periudhës së raportimit.
- 12 Nëse e drejta e njësisë ekonomike ndaj një rimbursimi ose një teprice varet nga zhvillimi ose mos zhvillimi i një ose më shumë ngjarjeve të pasigurta në të ardhmen jo plotësisht të kontrolluara prej saj, njësia ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar dhe nuk duhet ta njohë aktivin.

Matja e përfitimit ekonomik

- 13 Një njësi ekonomike e mat përfitimin ekonomik të gatshëm si rimbursim si shuma e tepricës në fund të periudhës së raportimit (e cila është vlera e drejtë e skemës së aktiveve minus vlerën aktuale të detyrimit të përfitimeve të përcaktuara) që njësia ekonomike ka një të drejtë për të marrë si një rimbursim, minus çdo kosto të lidhur. Për shembull, nëse një rimbursim mund t'i nënshtrohet një tatimi e jo vetëm tatimit mbi të ardhurat, një njësi ekonomike mat vlerën e rimbursimit neto të tatimit.
- 14 Në matjen e vlerës së një rimbursimi të gatshëm kur skema është likuiduar (paragrafi 11(c)), një njësi ekonomike përfshin kostot në skemën e shlyerjes së detyrimeve të skemës dhe kryerjen e rimbursimit. Për shembull, një njësi ekonomike ul tarifat profesionale nëse këto paguhen nga skema sesa nga njësia ekonomike dhe kostot e çdo primi sigurimi që mund të kërkojnë për të siguruar detyrimin për likuidim.

- 15 Nëse vlera e një rimbursimi përcaktohet si vlera e plotë ose proporcioni i tepricës, dhe jo vetëm një vlerë fikse, një njësi ekonomike nuk duhet të kryejë rregullime për vlerën në kohë të parasë, edhe nëse rimbursimi është i realizueshëm vetëm në një datë në të ardhmen.

Përfitimi ekonomik i disponueshëm si një reduktim në kontribute

- 16 Nëse nuk ka kërkesë minimale për financim për kontributet e lidhura me shërbimin në të ardhmen, përfitimi ekonomik i gatshëm si një reduktim në kontribute të ardhshme është kosto në të ardhmen e shërbimit për njësinë ekonomike për çdo periudhë gjatë jetëgjatësisë më të shkurtër të pritshme të skemës dhe jetëgjatësisë së pritshme të njësisë ekonomike. Kostoja e ardhshme e shërbimit e njësisë ekonomike përjashton shumën që do të përballohet nga punonjësi.
- 17 Një njësi ekonomike përcakton kostot në të ardhmen të shërbimit duke përdorur supozime konsistence me ato të përdorura për të përcaktuar detyrimin e përfitimeve të përcaktuara dhe me situatën që ekziston në fund të periudhës së raportimit financiar siç përcaktohet nga SNK 19. Për këtë arsye, një njësi ekonomike nuk adopton ndryshime në përfitime të siguruar nga një skemë e ardhshme deri kur skema të jetë ndryshuar dhe adopton një fuqi punëtore të qëndrueshme nëse njësi ekonomike nuk kryen reduktime në numrin e punonjësve të mbuluar nga skema. Në rastin më të fundit, teoria mbi fuqinë e ardhshme punëtore duhet të përfshijë reduktimin.

Efekti i kërkesës minimale të financimit mbi përfitimet ekonomike të disponueshme si një reduktim në kontribute në të ardhmen.

- 18 Një njësi ekonomike analizon çdo kërkesë minimale financimi në një datë të caktuar në kontribute të cilat kërkojnë të mbulojnë (a) çdo mungesë ekzistuese për shërbime në të shkuarën mbi bazën e financimit minimal dhe (b) shërbimit në të ardhmen.
- 19 Kontributet për të mbuluar çdo mungesë ekzistuese në bazën minimale të financimit përsa i përket shërbimeve të marra tashmë nuk ndikojnë në kontributet e ardhshme për shërbimin e ardhshëm. Ato mund të lindin një detyrim në përputhje me paragrafët 23–26.
- 20 Nëse ka një kërkesë minimale financimi për kontributet që lidhen për shërbim në të ardhmen, përfitimi ekonomik i disponueshëm si një reduktim në kontributet e ardhshme është shuma e:
- (a) çdo vlerë që redukton kontributet e ardhshme të kërkesës minimale të financimit në shërbimin e ardhshëm sepse njësi ekonomike kreu një parapagesë (d.m.th. pagoi shumën përpara se t'i kërkohej një gjë e tillë); dhe
 - (b) kostot e vlerësuar të shërbimit në të ardhmen në secilën periudhë në përputhje me paragrafët 16 dhe 17, minus kontributet e vlerësuar për kërkesën minimale të financimit e cila do të kërkohej për shërbim të ardhshëm në këto periudha nëse nuk do të kishte parapagesë siç përshkruhet në (a).
- 21 Një njësi ekonomike do të vlerësojë kontributet në të ardhmen të kërkesës minimale të financimit për shërbim të ardhshëm duke marrë parasysh efektin e secilës tepricë ekzistuese të përcaktuar nëpërmjet përdorimit të bazës minimale të financimit por duke përjashtuar parapagesën e përshkruar në paragrafin 20(a). Një njësi ekonomike do të përdorë supozime konsistence me bazë minimale financimi dhe, për çdo faktorë të pa specifikuar nga kjo bazë, supozime të qëndrueshme me ato të përdorura për të vendosur detyrimin e përcaktuar të përfitimit dhe me situatën e cila ekziston në fund të periudhës së raportimit financiar siç përcaktohet nga SNK 19. Vlerësimi duhet të përfshijë të gjitha ndryshimet e pritshme si rezultat i njësisë ekonomike i cili paguan kontributet minimale në kohën e caktuar. Megjithatë, vlerësimi nuk duhet të përfshijë efektin e ndryshimeve të pritura përsa i përket afateve dhe kushteve të bazës minimale të financimit të cilat nuk janë miratuar në praktikë ose mbi të cilat nuk është rënë dakord nga ana kontraktuale në fund të periudhës së raportimit financiar.
- 22 Kur një njësi ekonomike përcakton vlerën e përshkruar në paragrafin 20(b), nëse kontributet e ardhshme të kërkesës minimale të financimit për shërbim të ardhshëm e tejkalojnë koston e shërbimit në të ardhmen të SNK 19 në çfarëdo periudhe të dhënë, kjo tepricë redukton vlerën e përfitimit ekonomik të disponueshëm si një reduktim në kontribute të ardhshme. Megjithatë, vlera e përshkruar në paragrafin 20(b) nuk mund të jetë kurrë më pak se zero.

Kur një kërkesë minimale financimi mund të lindë një detyrim

- 23 Nëse një njësi ekonomike ka një detyrim sipas kërkesës minimale të financimit që të paguajë kontributet për të mbuluar një mungesë ekzistuese në bazën minimale të financimit përsa i përket shërbimeve tashmë të

marra, njësia ekonomike do të përcaktojë nëse kontributet e pagueshme do të jenë të disponueshme si një rimbursim ose reduktim në kontributet në të ardhmen pasi ato të jenë paguar në skemë.

- 24 Përsa i përket faktit se kontributet e pagueshme nuk do të jenë të aksesueshme pasi ato të jenë paguar në skemë, njësia ekonomike duhet të njohë një detyrim kur lind detyrimi. Detyrimi duhet të reduktojë aktivin neto të përcaktuar të përfitimit ose të rrisë detyrimin neto të përcaktuar të përfitimit në mënyrë që asnjë humbje ose fitim të pritët të rezultojë nga paragrafi i zbatuar 64 i SNK 19 kur paguhen kontributet.

25-26 [Fshirë]

Data e hyrjes në fuqi

- 27 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë Interpretim për periudha vjetore duke filluar nga ose pas datës 1 janar 2008. Lejohet aplikimi më i hershëm.
- 27A SNK 1 (rishikuar në 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Në përputhje me këtë u ndryshua paragrafi 26. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 janar 2009 e në vazhdim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.¹
- 27B *Parapagimet e një kërkesë minimale financimi* shtuan paragrafin 3A dhe ndryshuan paragrafët 16–18 dhe 20–22. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2011 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 27C SNK 19 (siç u ndryshua në 2011) ndryshoi paragrafët 1, 6,17 dhe 24 dhe fshi u paragrafët 25 dhe 26. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime kur ajo zbaton SNK 19 (siç u ndryshua në 2011).
- 27D SNRF 18, i publikuar në prill 2024, ndryshoi paragrafin 10. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

Periudha kalimtare

- 28 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Interpretim duke filluar nga periudha e parë e paraqitur në pasqyrat e para financiare mbi të cilat aplikohet Interpretimi. Një njësi ekonomike duhet të njohë çdo rregullim fillestar që lind nga zbatimi i këtij Interpretimi në fitimet e mbajtura në fillim të asaj periudhe.
- 29 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë ndryshimet në paragrafët 3A,16–18 dhe 20–22 duke filluar nga periudha më e afërt krahasuese e paraqitur në pasqyrat e para financiare në të cilën njësia ekonomike e zbaton këtë Interpretim. Nëse njësia ekonomike e ka zbatuar më parë këtë Interpretim përpara se ajo të zbatojë ndryshimet, ajo duhet të njohë rregullimin që rrjedh si pasojë e zbatimit të ndryshimeve në fitimet e mbajtura në fillim të periudhës më të afërt krahasuese të paraqitur.

¹ Në prill 2024, BSNK publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* dhe mbarti këto kërkesa të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* tek SNRF 18.